



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.52**

**30 prill**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr. 415, datë 27.4.2009

Për rritjen e  
.....

pensioneve 2471

Vendim i KM  
nr.416, datë 27.4.2009

Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve e të  
punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta  
financiare  
.....

2473

**VENDIM**  
**Nr. 415, datë 27.4.2009**

**PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rritjen, në masën 8 për qind, të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994;

d) shtesës mbi pension, të dhënë në përputhje me nenin 33, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Rritjen, në masën 10 për qind, të pensioneve të plota, të pjesshme dhe të reduktuara të invaliditetit dhe të pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 3.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritjen, në masën 10 për qind, të shtesave mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 38 e 39, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24, të ligjit nr.4171, datë 3.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

4. Rritjen, në masën 22 për qind, të:

a) pensioneve të plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Rritjen, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 e 4, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.5.2009 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit të jetë deri më 30.4.2009, përfshirë edhe këtë datë.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 10 276 (dhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj dhe më shumë se 20 552 (njëzet mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë në muaj.

7. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993,

“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 6 344 (gjashtë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

8. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensioneve të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet nr.401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, dhe nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, të Këshillit të Ministrave.

9. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 4, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

10. Pas rritjes së pensionit sipas përcaktimeve në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi, kompensohen me:

a) 190 lekë në muaj, pensionistët, që përfitojnë pension të plotë, minimal, pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur të ardhurat mujore nga pensioni dhe nga kompensimet, sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr.471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, të Këshillit të Ministrave, janë deri në 12 036 (dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë;

b) deri në 190 lekë në muaj, por në përpjesëtim të pensionit individual me pensionin e plotë minimal, pensionistët, që përfitojnë pension të pjesshëm pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur marrin pension të pjesshëm, është deri në 10 275 lekë në muaj. Këta pensionistë do të vazhdojnë të përfitojnë kompensimin e llogaritur sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr.471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, të Këshillit të Ministrave;

c) deri në 190 lekë në muaj, për pensionistët, që marrin pension pleqërie, në qytet, më të lartë se pensioni minimal, kur masën e pensionit plus kompensimet, sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr.471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, të Këshillit të Ministrave, e kanë nga 12 037 deri në 12 226 lekë.

11. Kompensimin deri në 190 lekë në muaj e përfitojnë edhe pensionistët, që do të marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, me datë fillimi nga 1.5.2009 e në vazhdim, kur shumata e të ardhurave mujore është deri në 12 226 lekë.

12. Pas rritjes së pensioneve, sipas pikave 1 e 4, të këtij vendimi, dhe zbatimit të kompensimeve, sipas pikave 8, 9 e 10, të këtij vendimi, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të pleqërisë, në qytet, nuk mund të jenë më të vogla se 12 226 lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e plota, në fshat, nuk mund të jenë më pak se 7 234 lekë në muaj.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi e që llogariten në shumën 4 294,5 (katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër presje pesë) milionë lekë, të përballohen nga fondi i kontingjencës, i buxhetit të vitit 2009, caktuar për rritjen e pensioneve.

14. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve, nga Posta Shqiptare sh.a. për 0.75 për qind në muaj, llogariten në shumën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë dhe do të përballohen nga fondi i kontingjencës, caktuar në buxhetin e vitit 2009.

15. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për të nxjerrë udhëzimet teknike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.416, datë 27.4.2009**

**PËR RITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE E TË  
PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA  
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake” dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Rritjen në masën 4 për qind të:

a) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensioneve suplementare të pleqërisë, pensioneve suplementare të invaliditetit, pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, janë bërë plotësisht të paafte për shërbim, pensioneve suplementare familjare, pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe pensioneve familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë dhe kjo datë;

b) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensioneve suplementare të pleqërisë,

pensioneve suplementare të invaliditetit, pensioneve suplementare të invaliditetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që për shkak të detyrës, janë bërë plotësisht të paaftë për shërbim, pensioneve suplementare familjare dhe pensioneve suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, humbasin jetën, për shkak të detyrës, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, me datë fillimi deri më 30.6.2008, përfshirë dhe kjo datë;

c) trajtimeve të veçanta financiare të pilotëve fluturues, në pension;

ç) trajtimeve të veçanta financiare të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension;

d) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake.

2. Rritjen në masën 10 për qind të trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë.

3. Rritjen në masën 4 për qind do ta marrin edhe të gjitha përfitimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, kur caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por me datë fillimi deri në 30.4.2009, përfshirë edhe këtë datë.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi e që llogariten në shumën 93 000 000 (nëntëdhjetë e tre milionë) lekë, të përballohen nga fondi i kontingjencës, në buxhetin e vitit 2009, caktuar për rritjen e pensioneve.

5. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.4.2009  
Doli nga shtypi më 30.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2009

Çmimi 8 lekë